

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

 

Nr./Br. U13101-10964

Data/Datum: 29.05.2020

Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Memorandum Mirëkuptimi

në mes të :



Syri i Vizionit (SiV),
dhe
Kuvendi Komunal i Gjakovës

Për zbatimin e projektit

„Përkrahja në zhvillimin e Edukimit dhe Punësimit – SEED faza e tretë”

Project implemented by:

volkshilfe.
SOLIDARITÄT



Page | 1/9

WITH FUNDING FROM



AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

1. Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

Ky Memorandum Mirëkuptimi është një letër e përbashkët e qëllimit mes Organizatës Jo Qeveritare "Syri i Vizionit", dhe komunës së Gjakovës. Memorandumi synon vazhdimin e një partneriteti të afërt mes këtyre dy partnerëve për implementimin e suksesshëm të projektit me titull „Përkrahja në zhvillimin e Edukimit dhe Punësimit – SEED faza e tretë”. Memorandumi i mirëkuptimit i projektit i cili ka filluar në Janar 2020 shpreh zotimin e të gjitha palëve të lartpërmendura për mbështetje të projektit për periudhën Janar 2020 dhe Dhjetor 2022.

2. Partnerët dhe palët e interesit

Organizata Jo Qeveritare Syri i Vizionit

Ka për qëllim promovimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë. Në përpjekjet e vazhdueshme për praktika demokratike, "Syri i Vizionit" i ka dhënë rol të veçantë promovimit të qeverisjes së mirë, përgjegjësisë, transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimarrje.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Komuna e Gjakovës

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Komuna e Gjakovës zhvillon politika, strategji për mbështetjen e zhvillimit ekonomik në Komunën e Gjakovës.

Drejtoria e Arsimit komuna e Gjakovës

Drejtoria e Arsimit si përgjegjëse për menaxhimin e arsimit në nivel komunal synon që në pajtim me kërkesat dhe nevojat e tregut të përkrah dhe të mbështes formimin e shkollave profesionale.

3 Projekti: Përkrahja në zhvillimin e Edukimit dhe Punësimit - SEED

Informatat elementare

Është qenësore për zhvillimin e sektorit të turizmit dhe hotelierisë që Komuna e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit ta prezantojë një sistem të përfundimit të praktikave të nxënësve që vijnë shkollimin e mesëm profesional në drejtimin e Turizmit dhe Hotelierisë në kabinete brenda shkollave dhe bizneset aktive në këto komuna. Duke u bazuar në strategjinë për përmirësimin e praktikës profesionale 2013 -2020 nga Ministria e Arsimit është qenësore fillimi i dialogut social mes akterëve: Shkollave profesionale, institucioneve si dhe biznesit, që të krijohet mundësia e bashkëpunimit të mirë me qëllim të krijimit të kuadrove adekuat bazuar në nevojat e tregut të punës.

Përmbajtja e projektit

Programi SEED mbështetet nga Agjencioni Austriak për Zhvillim - ADA dhe realizohet në dy shtete: në Kosovë dhe Serbi dhe ka për qëllim që të kontribuojë në zhvillimin strategjik të tregut të punës, një kontribut për uljen e varfërisë dhe barazinë gjinore në këto shtete. Programi tre vjeçar në Kosovë realizohet nga organizata "Syri i Vizionit" dhe fokusohet në nxitjen e partneritetit të qëndrueshëm që shtyn në krijimin e një kornize aktive të tregut të punës në nivel lokal dhe në qasjen në punësim formal. Një vëmendje e veçantë u është dhënë të rinjve dhe grave përmes: mbështetjes në punësim, lehtësimit në mes sektorit publik dhe privat, forcimit të organizatave partnere, ekspertizës dhe transferimit të njohurive, promovimin e punësimit ose vetëpunësimit në kushte të drejta pune dhe rritjes së ndërgjegjësimit për barazi gjinore.

Në të tri komunat Pejë, Gjakovë dhe Prizren, ku është paraparë realizimi i projektit, Syri i Vizionit do të punojë ngushtë me Komunitet e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Kulturës, Rinisë edhe Sportit, Zyrat rajonale të punësimit, Qendrat e Aftësimit Profesional, Zyrat për barazi gjinore në komuna, hotelet dhe restorantet, operatorët turistik, autoritete lokale të arsimit, Inspektoratet e Edukimit, Drejtoritë e zhvillimit ekonomik, Agjencitë e Zhvillimit Rural dhe Shkollat Profesionale – fokus i veçantë do i kushtohet drejtimi Hoteleri dhe Turizëm.

Në nivel lokal në komunat e lartcekura këta akterë do të njihen si Grupi Lokal për Punësim. Grupi Lokal për Punësim do të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet e projektit, duke marrë pjesë në dialog dhe punëtori që do organizohen në kuder të projektit, duke kontribuar në zbatimin e " Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2020 – 2025 për zhvillimin e burimeve njerëzore të punësueshme" në rajonin e Gjakovës

Ndërsa, në nivel kombëtar Syri i Vizionit do të organizojë takime dhe konferenca për të koordinuar dhe adresuar punët në mes të palëve të interesuara nga niveli lokal në atë qendror.

Rajoni dhe kohëzgjatja e projektit

Memorandumi mbulon periudhën duke filluar nga Janari 2020. Memorandumi do të bëhet me tri komunat Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit ku projekti është aktiv. Ky memorandum është valid për Komunitetin e Gjakovës. Projekti realizohet brenda periudhës 01.01.2020 deri 31.12.2022.

Synimet e projektit

Synimi i përgjithshëm i projektit është:

- Të kontribuojë në një zhvillim të qëndrueshëm të tregut të punës në Kosovë dhe Serbi.

Synimet specifike janë:

- Punësim i përmirësuar i grave dhe të rinjve
- Punësim dhe vetëpunësim i përmirësuar nën kushte të dinjitetshme të punës në baza të barazisë gjinore
- Qeveritë vendore, ekonomia dhe bizneset bashkëpunojnë në çështjet e punësimit në KLP

- Organizata të fuqizuara partnere nëpërmes bashkëpunimit transkombëtar, praktikave dhe transferimit të dijes, për partneritete aktive dhe të qëndrueshme me biznese, qeveri vendore dhe institucione tjera.
- Informata më të hollësishme lidhur me objektivat dhe aktivitetet e projektit janë të bashkëngjitur në projekt propozim. Propozimi është pjesë përbërëse e këtij Memorandumi.

Aktivitetet e përgjithshme:

1. Organizimi i punësive me "Këshillin Lokal të Punësimit" për të analizuar zbatimin e strategjisë për zhvillimin e burimeve njerëzore 2020 – 2025 dhe panit të veprimit për punësim 2020. Punëtorit do organizohen edhe për përditësimin e planeve të veprimit të punësimit për vitet në vazhdim (2021 – 2022).
2. Mbështetja e se paku 2 iniciativave me grante, të cilat propozohen nga anëtarët e "Këshillit Lokal për Punësim" të cilat janë në harmoni me planet e veprimit për punësim.
3. Krijimi i zyrës për zhvillim të karrierës, dhe punësimi i një koordinatori të karrierës brenda shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë, e cila do bëjë ndërlidhjen e shkollës me bizneset për përfundimin e praktikave profesionale nga nxënësit, promovimin e shkollës dhe pjesëmarrje në panairë, hulumtimin për nevojat e tregut dhe propozimi për hapjen e profileve karshi nevojave si dhe krijimin e një sistemi për përcjelljen e nxënësve pas përfundimit të shkollës.
4. Krijimi dhe akreditimi i dy moduleve të reja për shkollën e mesme profesionale ekonomike "Kadri Kusari" (Organizimi dhe menaxhimi i ngjarjeve kulturore) dhe një modul tjetër bazuar në nevojat e tregut të punës.
5. Organizimi i panairit "Dyert e hapura" për shkollën e mesme ekonomike "Kadri Kusari" pjesëmarrja e të gjithë nxënësve nga klasat e nënta në mënyrë të organizuar, për të tërhequr sa më shumë nxënës të regjistruar në këtë shkollë.
6. Organizimi i një konference në nivel qendror, për të diskutuar dhe avokuar për mbështetje për shkollat profesionale në ngritjen e kapaciteteve humane dhe teknike si dhe krijimin e lehtësirave për bizneset të cilët bashkëpunojnë me shkollat.
7. Renovimi i klasës dhe pajisja me elemente të kuzhinës, në shkollën e mesme ekonomike "Kadri Kusari" – krijimi i kabinetit të kuzhinës për praktika profesionale brenda shkollës.
8. Organizimi i një trajnimit me ekspert ndërkombëtar për mësimdhënësit e drejtimit hotelier turizëm për përdorimin e kuzhinës dhe përfundimin e praktikës profesionale me nxënësit brenda shkollës.
9. Pjesëmarrja e një mësimdhënësi dhe dy nxënësve të shkollës "Kadri Kusari" nga drejtimi hotelier dhe turizëm në konferencën vjetore të rrjetit evropian të shkollave të hotelierisë dhe turizmit, duke përfaqësuar shkollën në garat të cilët organizohen gjatë kësaj ngjarje.
10. Organizimi i trajnimit tre ditor për zhvillimin e planeve të biznesit për gra dhe të rinj.
11. Zhvillimi i fushatës vetëdijesuese për pjesëmarrjen e të rinjve dhe grave në edukim profesional, me theks të veçantë në sektorin e turizmit dhe hotelierisë.
12. Pjesëmarrja në dy ngjarje "Think Camps" në Serbi dhe organizimi i një ngjarje të tillë në Kosovë.

	Viti i Pare – tre mujor				Viti i Dytë – tre mujor				Viti i Tretë – tre mujor			
Aktivitetet	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
Aktivitetet e partnereve												
1.1 Takimi startues												
1.2 Takimi i Partnerëve												
1.3 Warm-Up takime												
Aktivitetet e programit												
2.1 Zhvillimi dhe akreditimi i dy moduleve te reja për shkollën profesionale (Menaxhimi dhe organizimi i ngjarjeve kulturore dhe Gastronomi, Teknologji ushqimore ose Agrobiznes)												
2.3 Organizimi i panairit "Dyert e hapura" për shkollën profesionale ekonomike.												
2.4 Organizimi i konferencës në nivel qendror												
2.5 Renovimi dhe furnizimi i qendrës së karrierës në shkollë												
2.6 Punësimi i një zyrtari/e në zyrën e karrierës në shkollën ekonomike												
2.7 Organizimi i tri punëtorive me këshillin lokal për punësim												
2.8 Zhvillimi i planeve të veprimit për punësim (2021 – 2022)												
2.9 Renovimi i hapësirës/klasës në ku do të vendoset kabineti i kuzhinës												
2.10 Furnizimi dhe funksionalizimi i kabinetit të kuzhinës në shkollën e mesme profesionale ekonomike.												
2.11 Organizimi i trajnimit për mësimdhënësit e drejtimit HT për përfundimin e praktikës profesionale brenda shkollës (ekspert i huaj)												
2.12 Organizimi/pjesëmarrja e një mësimdhënësi të drejtimit HT dhe nxënësve të shkollës së mesme ekonomike drejtimi HT në konferencën vjetore të rrjetit evropian të shkollave të hotelierisë dhe turizmit												

[illegible]

4. Roli dhe përgjegjësitë e partnerëve

Syri i Vizionit:

- Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi financiar i fondeve të projektit
- Takime dhe informimi i grupeve të akterëve për rrjedhat e projektit dhe organizimi i punëtorive me këshillin lokal për punësim.
- Përgatitja e veglave për moderimin e punëtorive me këshillin lokal të punësimit.
- Mbikëqyrja e koordinorit të projektit.
- Përgatitja e konkursit, shpallja dhe pjesëmarrje në përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën "Koordinator i zhvillimi të karrierës" për periudhën 01 shtator 2020 deri 31 dhjetor 2022.
- Informimi i të gjithë akterëve për vijueshmërinë e projektit.
- Aranzhimi i pjesës administrative të aplikimit për grande në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimit dhe Zhvillimit Ekonomik.
- Përgatitja e manualeve për aplikim për grande.
- Përditësimi dhe përdorimi i materialeve nga faze e parë dhe dyte e projektit SEED për fushatën vetëdijesuese në pjesëmarrjen e femrave dhe të rinjve në shkollim profesional drejtimi i HT.
- Angazhimi i ekspertit për zhvillimin e dy moduleve të reja për shkollën.
- Mbajtja e kontakteve me sekretariatën e rrjetit evropian të shkollave të hotelarisë dhe turizmit, dhe mbështetja e një mësimdhënësi dhe dy nxënësve në pjesëmarrjen në konferencën vjetore të këtij rrjeti.
- Përgatitja e dosjes së tenderit dhe përzgjedhja e kompanisë për renovimin/furnizimin e hapësirës/zyrës së karrierës dhe klasës/kabinetit të kuzhinës.
- Organizimi i trajnimit tre ditor për femra dhe të rinj në zhvillimin e planeve të biznesit.
- Mbështetja e shkollës ekonomike në organizimin e panairit të "Dyerve të hapura"
- Facilitimi dhe organizimi i një konference në nivel qendror

Drejtoria e Arsimit

- Pjesëmarrja dhe angazhim në punëtoritë e grupit lokal për punësim me një përfaqësues.
- Ofron mbështetje shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari" në krijimin e hapësirave për zyrën e karrierës brenda kësaj shkolle, dhe krijimin e kabinetit të kuzhinës.
- Zotohet se pas përfundimit të projektit SEED faza e tret, nga 01 janari i vitit 2023 do të lidh kontratë dhe fus në sistemin e pagës zyrtarin i cili do të punësohet në zyrën e karrierës brenda shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari", në mënyrë që zyra e karrierës të jetë funksionale edhe pas përfundimit të programit SEED faza tretë.
- Jap mbështetje shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari" në pagesën e anëtarësisë vjetore për të qenë pjesë e rrjetit evropian të shkollave të hotelerisë dhe turizmit, dhe ofron mbështetje për nxënësit dhe mësuesit në kësaj shkolle të marrin pjesë në ngjarje/trajtime që do ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe nxënësve të kësaj shkolle.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

- Pjesëmarrja në punëtoritë e këshillit lokal për punësim me një përfaqësues.
- Përzgjedhja e një zyrtari i cili do luajë rolin e sekretariatit të këshillit lokal për punësim, ndërsa Syri i Vizionit do ta mentorojë gjatë gjithë kohës.
- Angazhohet në monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit të strategjisë për rritjen e punësushmerisë 2020 – 2025 dhe planit të veprimit për punësim 2020.
- Mbështet iniciativat e këshillit lokal për punësim të cilat janë të parapara në planin e veprimit për punësim.
- Mbështet shkollën e mesme profesionale ekonomike "Kadri Kusari" në pjesëmarrjen në panairë dhe gara të ndryshme të cilat organizohen në nivel Evropian nga rrjeti evropian i shkollave të hotelerisë dhe turizmit.
- Angazhohet që gjatë panairit "Dyert e hapura" të ftojë biznese të cilat ndërlidhen me profilet e shkollës ekonomike që të marrin pjesë në këtë panair, në mënyrë që vizitorët (nxënësit e klasave të nënta dhe prindërit) të shohin se në çfarë ndërmarrje mund të punësohen pasi të përfundojnë shkollën e mesme.

5. Financat, raportimi, monitorimi dhe auditimi**Buxheti, financat dhe kontrolli financiar**

Buxheti i paraparë për tri vite është 303,000.00 Euro

Syri i Vizionit do të jetë përgjegjës për mbulimin e aktiviteteve të parapara në projekt, mirëmbajtjes së shënimeve të shpenzimeve dhe të bëjë transparente ato me të gjithë aktet e interesuar. Syri i Vizionit është përgjegjës për menaxhimin financiar të projektit, përfshirë edhe kontabilitetin sipas kontratës së paraparë me partnerin e projektit Volkshilfe.

Project implemented by:

Raportimi

Syri i Vizionit është i obliguar t'i informojë partnerët tjerë në rast të ndryshimeve në projekt. Syri i Vizionit ofron raportet periodike lidhur me progresin e projektit dhe zhvillimet në teren. Raportet do të jenë transparent me të gjithë partnerët. Në fund të projektit, Syri i Vizionit i dorëzon donatorëve dhe palëve tjera të interesit një raport vjetor të projektit i cili përfshinë një përshkrim të hollësishëm lidhur me vazhdimin dhe sistemin e praktikave dhe barazisë gjinore.

Auditimi

Projekti dhe pasqyra financiare duhet të ekzaminohet nga një auditor i pavarur vendor. Shpenzimet për mbulimin e auditimit duhet të mbuloj OJQ Syri i Vizionit nga mjetet e saja vetanake, pasi projekti nuk i parasheh ato shpenzime si të pranueshme.

Monitorimi, Vlerësimi dhe Rishikimi afat-mesëm

Syri i Vizionit në bashkëpunim me Drejtoritë e arsimit dhe zhvillimit ekonomik do të zhvillojnë indikatorë të thjeshtë dhe adekuat për monitorimin në baza vjetore për arritjet e projektit, gjë që lejon kohën e nevojshme për ndërmarrjen e masave të nevojshme për arritjen e objektivave të projektit. Raportet e vlerësimit vjetorë janë bazë për diskutimin e vazhdimësisë së sistemit të praktikave pas përfundimit të projektit.

7. Procedura e zgjidhjes së konflikteve

Palët e interesit duhet të përpiqen që ta zgjedhin çdo konflikt potencial përmes negociatave brenda një muaji. Nëse kjo nuk është e mundur, partnerët në konflikt duhet t'i dorëzojnë argumentet e tyre përkatëse me shkrim tek donatorët e pavarur.

Partnerët vlerësojnë progresin e projektit rregullisht dhe vlerësojnë të gjitha nevojat me fleksibilitet dhe me kohë. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin/aplikimin e dispozitave të këtij memorandumit duhet të zgjidhen përmes negociatave të drejtë për drejtë. Çdo amendamentin në këtë Memorandum duhet të arrihet me pajtim.

8. Territori

Gjakovë

Gjakovë, datë: 29.05.2020

Për Komunën e Gjakovës


Z. Adrian Gjini, Kryetar

Për OJQ Syri i Vizionit


Veton Mujaj, Drejtor Ekzekutiv

